



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: BO”Gjiguria”sh.p.k & 4 A-M Sh.p.k

Adresa: Tiranë, Njesia Bashkiake Nr.5 Rruga Ibrahim Rugova, Pranë Gardës së Republikës së Shqipërisë.

Lloji i procedurës së prokurimit: “Tender – i Hapur”.

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Ndërtimi i Godinës së Re të Ujësjellësit.””,

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-58958-05-26-2020

Fondi limit: 480.000.551,56 (katërqind e tetëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e një presje pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 12 muaj duke nisur nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 01/07/2020 Ora: 09:00

Buletini i Njoftimeve Publike:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “Elda –VI”sh.p.k NIPT-i K67106202W

Vlera 0(zero)

2. “Ante Group”sh.p.k NIPT-i J62904100D

Vlera 475,174,806,50 (katërqind e shtatëdhjetë e pesë milion e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e gjashtë presje pesëdhjetë)leke pa tvsh.

3. “BO”Gjiguria”sh.p.k & “4 A-M sh.p.k”
J62903456H & K92005016L

Vlera 470,353,557.45(katërqind e shtatëdhjetë milion e treqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë presje dyzet e pesë)lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë:

1. “Elda –VI”sh.p.k

NIPT-i K67106202W

Vlera 0(zero)

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “ **Elda-VI**”sh.p.k nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën e DT.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik“ **Elda-VI** “s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

2. Ante Group”sh.p.k

NIPT-i J62904100D

Vlera 475,174,806,50 (katërqind e shtatëdhjetë e pesë milion e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e gjashtë presje pesëdhjetë)leke pa tvsh

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Ante-Group ”shpk me ofertë 475,174,806,50 lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”,I ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Se pari : AK ka kerkuar ne kriteret e vecanta te kualifikimit si me poshte cituar:

4.Nje punesim mesatar i te pakten 300 (treqind) personave, per periudhen Qershor 2019 ~ Maj

2020 te vertetuar me;

4.1 Vertetim te leshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet nurnri I punonjesve per secilin muaj, per periudhën Qershor 2019 -Maj 2020.

Punonjesit e sipercituar duhet të jenë të siguruar me ditë të plota pune.

4.2 List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Qershor 2019 -Maj 2020.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave gjate shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur nga operatori ekonomik ne sistemin elektronik te app-se veren se:

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te app-se (listpagesat e shoqerise per periudhen Qershor 2019 - Maj 2020) te shoqerise "Ante - Group" shpk rezulton se punonjes te paraqitur ne listpagesat per periudhen Qershor 2019 - Maj 2020 pavaresisht nese jane me kohe te plote apo te paplote pune rezultojne vetem 226.

Per rrjedhoje operatori ekonomik "Ante - Group" shpk nuk ka permbushur kriterin e paraqitjes se numrit te punonjesve.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave gjykon se operatori ekonomik "Ante - Group" shpk, nuk zoteron kapacitet te mjaftueshem teknik per sa i perket *personelit te nevojshem* per te realizuar kontraten, per kete objekt prokurimi, duke mos permbushur Kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, cka bie ne kundërshtim me piken 1 germ a (a) dhe (b) te nenit 46 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin Publik" i ndryshuar ku percaktohet se: Operoret ekonomik, per te marre pjese ne procedural e prokurimit, duhet te kualifikohen pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhteme qe AK i vlereson te nevojshme .

Pra sa me siper cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me Kriteret e Vecanta te Kualifikimitl Kapaciteti pika 4, eshte i paplote, per rrjedhoje i pavlefshem,

Se dyti AK ka kerkuar ne kriteret e vecanta te kualifikimit si me poshte cituar:

5.Operoret ekonomik pjesemarres duhet te kene te punesuar si stafteknik per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome, CV, librezat e punes, te perfshire ne licensen e shoqerise si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqerise per periudhen Dhjetor 2019 - Maj 2020 e fundit stafi inxhinierik si me poshte:

- 3 (tre) Inxhinier Ndertimi (ku nje prej tyre te jete profili Strukturist)
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 2 (dy) Inxhinie Elektrik
- 1(një)Inxhinier Elektronik
- 2 (dy) Inxhinier Mekanik
- 1(nje) Inxhinier Gjeodet
- 1(nje) inxhinier Mjedisi
- 1(nje) Arkitekt

Komisioni i vleresimit të ofertave konstaton se në plotesimin e pikës 5, ku kerkohen 3(tre) Inxhier Ndertimi, operatori ekonomik ka paraqitur vetëm 2(dy), përkatësisht me inicialet K.P dhe P.Ç .Gjithashtu nga 2 (dy) Inxhimer Elektrikë të kërkuar, KVO ka konstatuar se është paraqitur vetem një përkatësisht me inicialet Ll.Sh.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur 1(nje) Inxhinier Elektronik, sic eshte kerkuar ne piken 5, gjithashtu nga 2 (dy) Inxhinier Mekanik, operatori ekonomik: ka paraqitur 1 perkatesisht me inicialet H.D

Referuar nenit 46, pika lib, te ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet t'is kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ate jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftesia teknike: operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe **personelin e nevojshëm**, per te zbatuar kontraten, sic eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrate." Ndersa ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit.".

Së treti AK ka kerkuar ne kriteret e vecanta te kualifikimit si me poshte cituar:

7. Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij te punesuar te cilet te figurojne ne listpagesat e shoqerise per periudhen Dhjetor 2019 - Maj 2020 te shoqeruar me kontrate pune , diplome dhe Libreze Pune, stafin mbeshtetes si me poshte:

2 (dy) inxhinier ndertimi

1 (nje) inxhinier elektrik,

1 (nje) inxhinier elektronik,

1 (nje) inxhinier mekanik

1 (nje) inxhinier telekomunikacioni,

Per Stafin e sipercituar tii paraqitet, kontrate pune , diplome dhe Libreze Pune .

- 1 (nje) Inxhinier - Auditues energjie (i pajisur me "Certifikate per auditimin e energjise)

(Per inxhinierin e eficenses se energjise duhet te jete keto dokumenta provues: Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar të ndertimit), Certifikata (Dip) per eficensen e energjise. Duhet të rezultojë ne listpagesat e shoqerise te pakten per 6 (gjashte) muajt e fundit.)

- 1 (nje) ekspert zjarrfikes te certifikuar ,

(Per ekspertin zjarrefikes certifikata e ekspertit zjarrefikes si dhe Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit si dhe te rezultojte ne listpagesat e shoqerise per 6 (gjashte) muajt e fundit.

- 2 (dy) inxhinier te pajisur me Cerifikate per Mbrojtjen e Shendetit dhe te Sigurise ne pune, leshuar nga autoritete te certifikuara, Te shoqeruara me kontrate pune, diplome, certifikate dhe Libreze Pune si dhe te rezultojte ne listpagesat e shoqerise per 6 (gjashte) muajt e fundit.

Komisioni i vleresimit te ofertave konstaton se ne plotesimin e pikes 7, operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per plotesimin e kriterit nr.7.

Nenenin 46, pika 1 b, te ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor I vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ate jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftesia teknike: operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, S1 dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten, sis; eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrate." Ndersa ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit."

Së katërti :AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 16 si më poshtë cituar:

16.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>

Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion	8 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	5 Cope	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 25 ton	4 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir 0.25 m3	2 Cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me cekic	2 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(një pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	8 cope	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	2 copë	Pronësi ose me qera
Sonde shpimi ø600mm deri ne 20m	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobot uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Automjet për mbjellje bari	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	4 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe Betoni	2 cope	Pronësi ose me qera
Autovinc	3 cope	Pronësi ose me qera
Pompe suvatimi	2 cope	Pronësi ose me qera
Pompë Uji	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul ngjeshes deri ne 2 Ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Makineri për shtresë betoni	1 cope	Pronësi ose me qera
Paisje për ngjitjen e tubave metalik	1 cope	Pronësi ose me qera

Bobcat	2 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator me zinxhir gome	2 cope	Pronësi ose me qera
Minifadrome	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	6 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	6 cope	Pronësi ose me qera
Trapan	4 cope	Pronësi ose me qera
Moto/gjenerator	3 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash HDPE	2 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	4 cope	Pronësi ose me qera
Paisje per pastrim dhe lucidim pllakave dhe mermerit	1 cope	Pronësi ose me qera
Paisje ndricimi per kantier	1 cope	Pronësi ose me qera
Kompaktor ngjeshes	3 cope	Pronësi ose me qera
Kompresor ajri	3 cope	Pronësi ose me qera
Makineri CNC per prerjen te formave te crregullta	1 cope	Pronësi ose me qera
Bango per profilet e aluminit	1 cope	Pronësi ose me qera
Tranxhe	2 cope	Pronësi ose me qera
Kalander	2 cope	Pronësi ose me qera
Skela	2500 m2	Pronësi ose me qera
Vinc Karrel	3 Cope	Pronësi ose me qera
UPS 400KVA(komulative)	2 cope	Pronësi ose me qera
Zyrë kantieri e lëvizeshme	2 cope	Pronësi ose me qera
Nyje inerte dhe prodhim betoni	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 150 copë
 - Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
 - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
 - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
 - Kulle ndricimi – 1 cope
 - Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë
- a)** *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerash/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jone aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b)** *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c)** *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d)** *Per fabriken e prodhimit të betonit, në rast se është në pronesi duhet të paraqitet akti i pronesisë i shoqeruar me leje mjedisore leshuar nga QKL. Në rast se operatori ekonomik ka kontratë qeraje duhet të paraqitet akti i pronesisë së qiradheut shoqeruar me lejen mjedisore leshuar nga QKL.Kontrata e qerash duhet të jete e noterizuar, ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- e)** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- f)** *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

g) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat e shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronesi ose me qera me qëllim verifikimi).

Operatori Ekonomik “Ante-group ”shpk ” ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

- Kamioni me targa AA324XY me kapacitet mbajtësi i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8.4 ton.(mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve min5-max10 ton)

-Kamioni me targa AA694YG me kapacitet mbajtësi i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 5 ton.(mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve min5-max10 ton)

-Kamion me targa AA692YG me kapacitet mbajtësi i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4.7 ton

-Kamion me targa AA695YG me kapacitet mbajtësi i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4.5 ton.

Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:

- Paraqitjen e 8 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 1,5 ton** dhe **max 2 ton** pasi nuk ka paraqitur asnjë kamionçinë me kapacitetin e kërkuar nga AK.
- Paraqitjen e 8 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 5 ton** dhe **max 10 ton** pasi ka paraqitur 2 kamion nga 8 të kërkuara me kapacitetin e kërkuar nga AK.
- Paraqitjen e 5 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 12 ton** dhe **max 17 ton** pasi nuk ka paraqitur asnjë kamionçinë me kapacitetin e kërkuar nga AK.
- Paraqitjen e 4 mjeteve me kapacitet mbajtës **min 25 ton** pasi nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitetin e kërkuar nga AK.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik . “Ante-group”shpk ” është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket mjeteve të kërkuar kamionçinë nga 1,5 -2 ton si dhe

Kamion me kapacitet mbajtës 12-17 ton, kamion min 3,5 ton-5 ton mjete të nevojshme për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

Së pesti: AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik si më poshtë cituar:

17. Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/ distributori i autorizuar nga prodhuesi me të cilin prodhuesi / distributori i autorizuar, autorizon ofertuesin të ofertojë këto mallra në këtë procedurë prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Tel/fax/email. Ofertuesi të paraqesë, kataloge ose fragmente të katalogut të prodhuesit për listën e materialeve të mëposhtme që do të ofrojnë ku të paraqiten të dhënat teknike baze. Në rast se katalogjet apo broshurat janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe sipas legjislacionit në fuqi.

- 1.Bojra
- 2.Pllakat
- 3.Paisjet elektrike
- 4.Kamerat
- 5.Sistemin e kondicionimit
- 6.Ndricimi

Në përmbushje të kriterëve të kërkuar në DST Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren operatori ekonomik “Ante-Group” nuk ka paraqitur në sistemin elektronik autorizim distributori për paisjet e mësipërme.

Pra, sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me pikën 17 është i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Së Gjashti: AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

8.Të ketë në stafin e punonjesve të pasqyruar në list pagesat e shoqërisë për të paktën 2 muajt e fundit të paktën 60 (gjashtëdhjetë) punonjës të pajisur me deshmë kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të si më poshtë:

- | | |
|----------------------|--------------|
| - teknike ndertimi 2 | Kategoria II |
| - karpentier 5 | Kategoria I |

- hekurkthyes 4	Kategoria I
- murator/suvatues 10	Kategoria I
- pllakashtrues 8	Kategoria I
- elektrikist 11	3 Punonjës Kategoria IV dhe 8 Punonjës Kategoria III
- hidraulik 6	Kategoria II
- bojaxhi 7	Kategoria I
- punetor duroalumini 5	Kategoria I
- montator 2	Kategoria II

(Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion 60(gjashtedhjetë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi.

Operatori ekonomik “ Ante-group“ shpk në përmbushje të këtij kriteri nga 60(gjashtedhjetë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, nuk ka paraqitur asnjë punonjës , çka bie në kundërshtim me kriterin e kërkuar në DST nga Autoriteti Kontraktor.

Pra sa më sipër operatori ekonomik “Ante-Group“sh.p.k nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket **personelit të nevojshëm** për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , çka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, **duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....***

Për rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti pika 8, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, BO” Gjikuria sh.p.k &”4 A-M “sh.p.k me vlerë të ofertës: 470,353,557.45(katërqind e shtatëdhjetë milion e treqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë presje dyzet e pesë lekë pa tvsh se është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **07.07.2020**

Ankesa: JO